



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 68, Datë 16/03/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 82, datë 08.10.2015, e Znj. E. Z., me objekt pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore<sup>1</sup> dhe përkatësisë në një grup të veçantë<sup>2</sup>, nga ana e Akademisë së Sigurisë (Qendrës së Formimit Policor).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**K O N S T A T O I:**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, në periudhën kohore mars-prill 2014, Znj. E. Z. ka aplikuar dhe i është nënshtruar 3 fazave të konkurimit, për të ndjekur studimet pranë kësaj Qendre. Ankuesja pretendon se është shpallur fituese në të tre fazat e para të konkurimit dhe në muajin dhjetor 2014 është njoftuar për t’u paraqitur pranë ambienteve të Akademisë së Sigurisë, për të kryer kontrollin mjekësor, pasi ajo kishte dorëzuar paraprakisht raportin mjeko-ligjor. Në bazë të përgjigjeve të analizave, Znj. E. Z. rezultoi se ishte mbartëse e virusit “Hepatit B” dhe si

<sup>1</sup> Ankuesja është diagnostifikuar si mbartëse e virusit “Hepatit B”.

<sup>2</sup> Në kushtet kur ankuesja nuk është shprehur se në cilin grup të veçantë bën pjesë, Komisioneri ka vlerësuar, mbështetur në shpjegimet e dhëna në ankesë, se grupi i veçantë, ku bën pjesë ankuesja është ai i konkurrentëve që kanë marrë pjesë në konkursin për praninë në Akademinë e Policisë, në vitin 2014.

rrjedhim autoritetet përgjegjëse të institucionit mësimor i komunikuan ankueses, se me këtë diagnozë nuk mund të lejohej të vazhdonte studimet pranë kësaj Akademie. Ankuesja pretendon gjithashtu, se ajo duhej të ishte njoftuar më parë nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, lidhur me faktin se kontrolli shëndetësor ishte fazë e mëpasshme nga testimet e tjera, për t'u pranuar në Akademi dhe se mos kalimi i kësaj faze do të sillte rrjedhimisht skualifikimin e saj.

Për sa më sipër, ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Akademisë e Sigurisë, si dhe në vijim kërkon që t'i jepet mundësia për të ndjekur këtë Akademi.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

☐ Pas analizimit të ankesës nr. 82, datë 08.10.2015, e Znj. E. Z., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

☐ Mbështetur në nenin<sup>3</sup> 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Akademisë së Sigurisë, me shkresën nr. 852/1, datë 15.10.2015, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja E. Z.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Akademia e Sigurisë dërgoi shkresën nr. 2581, date 03.11.2015, ku jepen sqarimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Fillimisht, Akademia e Sigurisë i bën të ditur Komisionerit misionin e saj, i cili konsiston në zhvillimin e transmetimin e dijevenëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë publike, për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligj zbatuese.

Në vijim, sqarohet se në nenin 38 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” janë përcaktuar kriteret për pranimin në Akademinë e Policisë dhe parashikohet se: *“Pranimi në Akademinë e Policisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë:*

*a) Të jetë shtetas shqiptar;*

---

<sup>3</sup>Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

- b) *Të mos jetë përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil;*
- c) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- d) ***Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;***
- e) *Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;*
- f) *Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;*
- g) *Të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;*
- h) *Të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B”.*

Sipas shkresës së sipërpërmendur, testimi mjekësor për aplikantët që fillojnë shkollimin bazë të Policisë së Shtetit kryhet nga Qendra e Profilaksisë dhe Mjekimit, që është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shtetit. Këtë testim e kryen një komision mjekësor me mjekë specialistë të fushave të ndryshme, ku çdo aplikant, i nënshtrohet analizave e kontrolleve mjekësore dhe është pikërisht ky komision, që merr një vendim në bazë të rezultateve përfundimtare mjekësore.

Në këtë kontekst, Akademia e Sigurisë e adreson Komisionerin t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të siguruar informacionin e nevojshëm, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja E. Z..

- ☐ Për sa më sipër, Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 852/3, datë 09.11.2015, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku iu kërkua informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 1656/1, datë 20.11.2015, ku e bën me dije Komisionerin se për t’u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë, aplikanti i nënshtrohet procedurave të konkurimit sipas rendit zbritës. Znj. E. Z. ka qenë aplikante në konkurim për pranimin në Shkollën Bazë të Policisë, në vitin 2014. Pas përfundimit të tre fazave të konkurimit, atë të testimit me shkrim, testit të aftësive fizike dhe intervistës me gojë, ajo është përzgjedhur që t’i nënshtrohej fazës pasardhëse të konkurimit, pikërisht fazës së kontrollit mjekësor. Në përfundim të këtij kontrolli, ajo rezultoi “e paaftë” për t’u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë, duke mos u bërë pjesë e vazhdimit të fazave të tjera të konkurimit. Njoftimi për rezultatet e arritura, si për të gjithë aplikantët e tjerë edhe për Znj. E. Z., është bërë në përfundim të çdo faze konkurimi.

- ☐ Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 178, datë 02.12.2015, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Akademisë së Sigurisë, me qëllim kryerjen e verifikimeve, mbi ankesën e Znj. E. Z.”, inspektorët e KMD-së u paraqitën për inspektim pranë Qendrës së Profilaksisë dhe Mjekimit.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-së u takuan me Drejtuesin e Qendrës së Profilaxisë dhe Shërbimit, Z. D. C., i cili sqaroi se konkurimi i aplikantëve për në Akademinë e Policisë kryhet në disa faza, të cilat janë të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”. Faza e parë konsiston në testimin teorik, faza e dytë konsiston në testimin praktik dhe faza e tretë konsiston në kontrollin mjekësor të aplikantëve. Znj. E. Z., pasi ka kaluar dy fazat e para të konkurimit, në fazën e tretë, pikërisht gjatë kontrollit mjekësor rezultoi si mbartëse e virusit të Hepatitit B. Referuar nenit 12, pika 2 të Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”, të gjithë aplikantët, të cilët rezultojnë në përfundim të kontrollit mjekësor të jenë mbartës të antigenit pozitiv (aktiv ose pasiv) nuk pranohen në Akademinë e Sigurisë. Në këtë kontekst, Znj. E. Z., e cila ka rezultuar mbartëse e virusit Hepatit B, është skualifikuar.

Në bazë të verifikimeve të kryera, rezultoi se me të njëjtën diagnozë, janë skualifikuar edhe 16 aplikantë të tjerë, të cilët kanë konkuruar në vitin 2014, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Sipas Drejtuesit të Qendrës së Profilaxisë dhe Shërbimit, Hepatiti B është një sëmundje, e cila kërkon kurim të vazhdueshëm me antiviralë. Në mungesë të mjekimit të duhur, ky lloj hepatiti mund të agravohet e të kalojë në cirozë të mëlçisë. Sipas Z. D. C. edhe punonjës efektivë të Policisë së Shtetit që janë diagnostikuar si mbartës të antigenit pozitiv (aktiv ose pasiv) janë konsideruar “të paaftë”<sup>4</sup> për të punuar në Policinë e Shtetit.

I pyetur në lidhje me faktin, se përse kontrolli mjekësor nuk është parashikuar si fazë e parë e konkurimit për aplikantët që duan të pranohen në Akademinë e Sigurisë, Z. Canka sqaroi se nëse kontrolli mjekësor do të ishte parashikuar si fazë e parë e konkurimit, do të kishte patur një kosto të madhe, pasi numri i aplikantëve është tepër i madh.

## **Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, Komisioneri gjykon se:**

### **I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:**

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” është një akt nënligjor, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Policisë së Shtetit, përcaktimin e parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale

---

<sup>4</sup>Referuar nenit 51, të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit, përcaktimin e ecurisë në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.

Në kreun II të saj, Rregullorja e Policisë së Shtetit parashikon procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë. Në nenin 135 të kësaj Rregulloreje parashikohet:

*“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:*

- a) testimi me shkrim;*
- b) testimi të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimi të aftësive të shkruarit;*
- ç) testimi psikologjik;*
- d) kontrollit shëndetësor;**
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.*

*2. Drejtori i Policisë së Shtetit përcakton rregullat e testimi, kufirin minimal të pikëve, si dhe peshën specifike që do të ketë secili prej testeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në raport me rezultatin e përgjithshëm të aplikantit”.*

Për sa më sipër, rezulton se aplikanti, i cili konkuron për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet disa fazave të konkurrimit, të cilat janë renditur dhe kryhen sipas një rradhe të caktuar, të përcaktuar shprehimisht në nenin 135, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, ku kontrolli shëndetësor kryhet pas kryerjes së testimi me shkrim, testimi të aftësive fizike, intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese e testimi të aftësive të shkruarit dhe testimi psikologjik të aplikantit.

Referuar nenit 136, pika 3, gërma a), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, struktura përgjegjëse për kryerjen e kontrollit shëndetësor, është Komisioni i Kontrollit Shëndetësor. Në nenin 137 të VKM-së së mësipërme parashikohet se aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimi. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit. Procesi i ekzaminimeve mjekësore të aplikantëve, menaxhohet nga Komisioni për Kontrollin Shëndetësor. Për ekzaminime të veçanta, Komisioni vendos për institucionin shëndetësor, ku do të kryhet ekzaminimi. Realizimi i kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore, bëhet sipas

marrëveshjes midis Policisë së Shtetit dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm, të Kujdesit Shëndetësor.

Referuar sa më sipër, Znj. E. Z. ka kaluar suksesshëm testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike, intervistën me gojë, ushtrimet vlerësuese e testimin e aftësive të shkruarit, si dhe testimin psikologjik. Në fazën pasardhëse, pikërisht gjatë kontrollit shëndetësor, ajo rezultoi mbartëse e virusit *Hepatit B*. Referuar nenit 12, pika 2<sup>5</sup> të Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”, të gjithë aplikantët, të cilët rezultojnë në përfundim të kontrollit mjekësor të jenë mbartës të antigenit pozitiv (aktiv ose pasiv) nuk pranohen në Akademinë e Sigurisë.

Si rrjedhim, në mbështetje të nenit 140, pika 2<sup>6</sup>, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Znj. E. Z. është skualifikuar.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se edhe 16 aplikantë të tjerë, që kanë konkurruar në vitin 2014, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, pas kontrollit shëndetësor kanë rezultuar me diagnozën e ankuses dhe janë skualifikuar, sikurse ajo.

Në këto kushte, rezulton se janë zbatuar parashikimet përkatëse të akteve nënligjore të sipërpërmendura, lidhur me procedurat e pranimit dhe skualifikimit të konkurrenteve.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

---

<sup>5</sup>Neni 12 i Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit” parashikon :  
*“1.Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe të mos jenë bartës të ndonjë sëmundjeje ngjitëse.  
2.Nuk do të pranohen ata kandidatë të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv so jo aktiv). Nëqoftë se student ose kursanti, gjatë periudhës së shkollës del me Hbs pozitiv, largohet nga shkolla ose nga kursi.  
3.Nuk do të pranohen as ata kandidatë, të cilët janë bartës të hepatitis C apo virusit HIV dhe që mund të kenë në vijueshmëri shenja përmirësimi”.*

<sup>6</sup>Neni 140, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” parashikon: *“Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrimit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurrimit dhe skualifikohet”.*

Në këtë kontekst, vlerësohet se Znj. E. Z.nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, krahasuar me persona apo grupe personash në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, pasi të gjithë konkurentët që nuk kanë plotësuar kriteret mjekësore të përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse janë skualifikuar.

## **II. Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja.**

Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe për shkak të gjendjes shëndetësore.

*“Gjendja shëndetësore” dhe “Përkatësia në një grup të veçantë” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, **përkatësinë në një grup të veçantë**, ose me çdo shkak tjetër”.*

Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ rezulton se janë zbatuar dispozitat përkatëse të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”” mbi ndjekjen e procedurave të konkurimit për rekrutimin e studentëve të rinj, si dhe për skualifikimin e tyre në rast mos plotësimi të kriterëve përkatëse, ndër të cilat edhe ato mjekësore.

Përgjatë procesit të shqyrtimit të çështjes rezultoi se në konkursin e zhvilluar në vitin 2014 për pranimin e studentëve të rinj pranë Akademisë së Sigurisë, janë skualifikuar 17 konkurentë, ndërmjet të cilëve edhe ankuesja, të cilët pas ekzaminimit mjekësor kanë rezultuar me diagnozën “Hepatit B”.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ndaj ankueses nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo mosveprim nga Akademia e Sigurisë, që të ketë krijuar baza për mohimin e barazisë ndaj saj, ose që ta kenë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të ndryshëm, kur është ndodhur në rrethana të njëjta ose të ngjashme, me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të akteve nënligjore të sipërpërmendura, të gjithë konkurentët që pas ekzaminimit mjekësor janë diagnostifikuar me sëmundjen “Hepatit B” janë skualifikuar, pavarësisht se ata kanë rezultuar fitues në fazat e mëparshme të konkurimit. Duke qene se kriteret mjekësore për pranimin në Akademinë e Sigurisë, duhen konsideruar njëjloj si kriteret e tjera që janë përcaktuar në aktet përkatëse, mosplotësimi i tyre pasjell skualifikimin e konkurentëve.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore apo të përkatësisë në një grup të veçantë.

Për sa i përket pretendimit të ankueses, se ajo duhej të ishte njoftuar më parë nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, lidhur me faktin se kontrolli shëndetësor ishte fazë e mëpasshme nga testimet e tjera, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë dhe se mos kalimi i kësaj faze do të sillte rrjedhimisht skualifikimin e saj, Komisioneri gjykon se procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë janë të parashikuara shprehimisht në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, i cili është një akt nënligjor që mund të disponohet nga cilido, që është i interesuar për t’u informuar mbi fazat e konkurimit pranë Akademisë së Sigurisë.

### **III. Lidhur me justifikimin e subjektit ndaj të cilëve drejtohet ankesa, Komisioneri gjykon se:**

Nëpërmjet korrespondencës zyrtare institucionet përgjegjëse kanë sqaruar faktin se procedurat e konkurimit dhe skualifikimi i konkurentëve që nuk plotësonin kriteret, si ato fizike, edhe ato mjekësore etj., është kryer në zbatim në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit””.

Në kushtet kur aktet e sipërpërmendura parashikojnë me hollësi fazat e mënyrën e konkurimit, si dhe kriteret fizike, mjekësore etj. të cilat duhen plotësuar nga konkurentët për t’u pranuar në Akademinë e Policisë, përzgjedhja dhe skualifikimi i tyre është kryer konform këtyre parashikimeve.

Znj. E. Z. është cilësuar “e paaftë për Akademinë e Sigurisë” nga ana e Komisionit për Kontrollin Shëndetësor, i cili është mbështetur në rezultatet e analizave laboratorike, ku ankuesja ka rezultuar me antigen pozitiv (Hepatit B). Në bazë të pikës 2, të nenit 12, të Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike – shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit” parashikohet se nuk do të pranohen ata kandidatë, të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv ose jo aktiv).



Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u ndal më gjatë për shqyrtimin e çështjes së Znj. E. Z., pasi pavarësisht se Akademia e Sigurisë ka ndjekur parashikimet në aktet përkatëse nënligjore, a janë në vetvete këto parashikime diskriminuese për sa i përket kriterit të vendosur për skualifikimin e konkurrentëve që diagnostifikohen si mbartës të virusit “Hepatit B”.

Nëpërmjet Vendimit nr. 6, datë 14.01.2016, Komisioneri e pezulloi përkohësisht shqyrtimin e ankesës së Znj. E. Z., pasi ngarkoi strukturat e tij përkatëse për kryerjen e një studimi, qëllimi i të cilit ishte kryerja e një procesi krahasimor ndërmjet vendeve të ndryshme europiane, lidhur me parashikimet që përmbanin aktet nënligjore përkatëse mbi kriteret mjekësore të përcaktuara për rekrutimin e studentëve në akademitë analoge me Akademinë e Sigurisë Shqiptare.

Mbështetur në përfundimet e këtij studimi dhe informacioni i marrë nga dhjetë shtete anëtare<sup>7</sup> të Equinet-it, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është anëtar, rezulton se të gjithë shtetet që kanë dërguar informacion kanë parashikuar kritere specifike shëndetësore/mjekësore për kandidatët që do të rekrutohen nga Institucionet Arsimore respektive të edukimit policor.

Vende të ndryshme kanë vendosur kritere të ndryshme mjekësore, lidhur procesin e rekrutimit/skualifikimit të studentëve në institucionet mësimore të formimit policor.

Njëri prej këtyre kriterëve specifike është pikërisht edhe rasti i të qënurit mbartës i antigenit pozitiv (aktiv ose pasiv), fakt që e skualifikonte konkurrentin.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 17, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të Znj. E. Z., nga ana e Akademisë së Sigurisë.

---

<sup>7</sup> Bëhet fjalë për Lituaninë, Greqinë, Hungarinë, Sllovakinë, Italinë, Kroacinë, Letoninë, Gjermaninë, Belgjikën dhe Republikën Çeke.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Irma BARAKU**  
**KOMISIONERI**

(Shkak: gjendja shëndetësore, përkatësia në një grup të veçantë;  
Fusha: Arsim)